

ILIRIAN MARTIRI

**VLERA GJUHËSORE QË GJEJNË SHPREHJE NËPËRMJET
RAPORTEVE KUPTIMORE - SINTAKSORE NË SHQIPEN E SOTME**

Megjithë numrin në rritje të studimeve lidhur me problematikën që paraqesin raportet kuptimore – sintaksore në gjuhën shqipe, ndihet ende nevoja e plotësisimit të kuadrit të ekspertimit studimor në këtë fushë. Arsyeja qëndron jo vetëm në thelbin e marrëdhënieve mes gjuhës dhe mendimit, por mbi të gjitha në nevojat praktike të dinamikës jetësore komunikative. Në të vërtetë, çdo aspekt i jetës dhe i veprimtarisë njerëzore mbështetet te komunikimi. Rrjedhimisht, edhe kërkesa për studime të tilla, veçanërisht në fushë të shqipes, vijon të mbetet e hapur, sa kohë të ndihet i nevojshëm ekspertimi gjuhësor, filozofik e profesional për zgjidhje cilësore të problemeve jetësore.

Duke hulumtuar lidhur me konceptin e vlerës gjuhësore, vihet re se studimet në gjuhësinë e shekullit XX, duke nisur nga Saussure, kanë të bëjnë me shqyrtimin e vendit ose të funksionit të një elementi në brendësi të një rrjeti relacionesh¹. Në vijim, me shtrimin e çështjes për identifikimin e tyre në terrenin gjuhësor, janë kryer studime që kanë në bazë konceptin e variablave me vlera korresponduese sasiore e cilësore.

Gjithsesi, në këtë kuadër ndihet i nevojshëm edhe një parashtrim i disa aspekteve bazë, që kanë të bëjnë me sfondin filozofik të këtij koncepti, natyrisht, në kushtet e një kumtese. Kështu, kur shtrohet për shqyrtim koncepti “vlerë” (angl. *value*, fr. *valeur*), është fjala për vlerën e një funksioni, që, veç aspektit filozofik, të njohur si funksionalizëm, shqyrtohet edhe nga aspekti logjik, nga ai matematik, biologjik, etj.

Megjithatë, duke u kthyer te koncepti i vlerës gjuhësore, në këtë kumtesë vëmendja do të përqendrohet në atë që quhet “**shpjegimi funksional**” (*functional explanation*)². Pra, është fjala për shpjegimin e një dukurie, ku nxirren në pah më tepër cilësitë funksionale të elementeve kontribuese sesa rolet e tyre fizike ose mekanike. Duket se në këtë mënyrë arrihet të realizohet më qartë edhe ideja e Saussure-it, lidhur me shqyrtimin e vendit ose të funksionit të një elementi në brendësi të një rrjeti relacionesh, integruar në kuadrin e shpjegimit funksional, për identifikimin e vlerave.

¹ Petter Matthews, *Oxford Concise Dictionary of Linguistics*, Oxford University Press, 2007, p. 425.

² Simon Blackburn, *Oxford Dictionary of Philosophy*, Oxford University Press, 1996, p. 150.

Ky fokusim u zgjodh si më i përshtatshmi për këtë kumtesë, për arsye të dobisë që paraqet në përpilimin e një panorame të problematikës gjuhësore dhe psiko-sociale të komunikimit në gjuhën shqipe, nëpërmjet studimit të çështjeve semantiko-sintaksore në këtë gjuhë.

Zgjedhja e kësaj metode shqyrtimi për identifikimin e vlerave e ka dëshmuar suksesin e saj në studimet e kryera në fushat humanitare dhe shoqërore nga studiues të spikatur me autoritet ndërkombëtar, në të gjitha kohët. Kështu, janë të njohura studimet për vlerat në fushën e doktrinave filozofike laike e teologjike, studimet lidhur me normat shtetërore e ndërshtetërore, administrative, juridiko-ligjore, ekonomiko-financiare, arsimore, intelektuale, shkencore, kulturore, artistike, sportive, profesionale, gjithashtu, në kuadrin pronësor, mjedisor, klimatologjik etj., pa lënë mënjanë studimet lidhur me parimet kombëtare, krahinore, tradicionale, morale, zakonore e kanunore, të spektrit antropologjik kulturor.

Në studimin që po parashtrohet nëpërmjet kësaj kumtese, vëmendja synohet të përqendrohet në gjendjen e vlerave gjuhësore në fushë të shqipes. Në këtë perspektivë bëhet i mundur trajtimi i problemeve gjuhësore, veçanërisht i atyre kuptimore-sintaksore, që vihen re gjatë procesit të përditshëm komunikativ, në rastin konkret, në ligjërimin e shkruar. Një bazë të sigurt në shqyrtimin e kësaj problematike përbën, edhe për shqipen, përvoja e trajtimit shkencor të saj nga studiues të ndryshëm.

Shqyrtimi rast pas rasti i dukurive kuptimore-sintaksore dhe, në këtë kuadër, vendosja e tyre në një perspektivë panoramike të parashtrimit shkencor, bën të mundur identifikimin e sfondit kulturor, mjedisit gjeografik, familjar e shoqëror, formimit arsimor, prejardhjes apo vendbanimit, profesionit, statusit shoqëror të përdoruesit gjuhësor të shqipes.

Nuk duhet harruar se nëpërmjet kodit gjuhësor, realizohet ndërfaqësimi me të gjitha fushat e jetës. Kështu, dukuritë kuptimore-sintaksore, në relacionet e tyre të natyrshme, të shqyrtuara në sfondin e një perspektive të përgjithshme komunikative, pavarësisht kodit gjuhësor të shqipes, bëhen evidente në sferën e mendimit individual e shoqëror në çdo nivel të komunikimit.

Prej kohësh vijon të shtrohet çështja e një komunikimi cilësor në të gjitha nivelet e shoqërisë shqiptare. Në këtë kuadër mbështetet edhe diskutimi jo vetëm në parim, por edhe për çdo formë a trajtë gjuhësore, lidhur me mesazhin që shpreh, me vendin e secilës në situatën komunikative përkatëse, pa mohuar lidhjet me njësitë më të afërta.

Kështu, bëhet i mundur kalimi nga një shqyrtim i thjeshtë i një forme sintaksore, për sa i përket kuptimit të saj, në një panoramë studimore të hierarkisë së vlerave, që lidhen me vendin ose funksionin e secilit element formal e kuptimor, gjuhësor brenda rrjetit të lidhjeve. Pikërisht këtu synojnë autorët studiues dhe hartues të manualeve dhe të botimeve të ndryshme

universitare, parauniversitare, por edhe të metodave dhe të udhëzuesve për nevoja të ngutshme të përdorimit gjuhësor.

Për një komunikim sa më të efektshëm, përdoruesit gjuhësor i nevojitet saktësi në shprehjen e ndjenjave dhe të mendimeve. Në këtë mënyrë, synohet që përdoruesi i gjuhës shqipe, nëpërmjet komunikimit të tij, të jetë i pozicionuar në paraqitjen e çdo elementi formal-kuptimor të integruar në tërësinë e mesazhit të tij, në pajtim të plotë me strategjinë e tij komunikative, për arritjen e qëllimeve vetjake. Por, që ta arrijë këtë, atij i duhet të jetë në akord me normat gjuhësore të pranuar shoqërisht, pra, që të kuptojë dhe të jetë i kuptueshëm, ndërkohë që pranimiti i mesazhit varet edhe nga faktorë të tjerë socio-kulturorë.

Në këtë perspektivë, studiues të ndryshëm kanë parashtruar nevojën për trajtimin e problemeve të shprehësisë sintaksore. Kështu, Mahir Domi (1983) e vë theksin te vëmendja e veçantë që u duhet kushtuar çështjeve të sintaksës shprehëse³. Seit Mansaku (1985) thekson se çështje të tilla në gjuhën letrare shqipe kanë një fushë të gjerë veprimi e përdorimi dhe se numri i tyre duket të jetë i lartë⁴. Nga ana e saj, Shefkije Islamaj (1986) e vë theksin veçanërisht te studimi i çështjeve të sinonimisë në fjali, si një ndihmesë e rëndësishme për kryerjen e interpretimeve të reja sintaksore të tekstit⁵, rrjedhimisht, për të shkruar drejt një mbulimi sa më të plotë të realitetit kuptimor në fushë të shqipes, parë gjithashtu në perspektivën studimore të gjuhëve të qytetërimeve kryesore, duke pasur parasysh analizat dhe sintezat përkatëse, thelbin e problematikave të shqyrtuara, arritur nëpërmjet hierarkisë së vlerave shkencore të platformave studimore të realizuara për qëllime analoge.

Në botimin akademik të sintaksës shqipe (2002) vihet në dukje se ndryshimi i një ndërtimi, zëvendësimi i tij me një tjetër, bën të zbulohen herë-herë edhe ndryshimet që ekzistojnë midis dy ndërtimeve pak a shumë të barasvlershme për nga përmbajtja, ngjyrimet sintaksore a stilistikore që ka secili ndërtim⁶. Kështu, marrin rëndësi të veçantë përbërësit kuptimorë të mishëruar në fushën e sintaksës. Nëpërmjet një vëzhgimi dhe studimi të thelluar teorik dhe empirik vëmendja përqendrohet te ruajtja ose jo e tërësisë kuptimore të fjalive dhe të periudhave në shqyrtim, më konkretisht - tek elementet semantike që mbeten edhe pas zëvendësimeve shndërruese të formës, si dhe tek elementet semantike që hyjnë si risi nëpërmjet këtij procesi.

³ M. Domi, *Çështje të kulturës së gjuhës në fushën e sintaksës*. “Gjuha jonë”, nr. 3, Tiranë, 1983, f. 20.

⁴ S. Mansaku, *Rreth sinonimisë sintaksore në shqipen e sotme letrare*. “Gjuha jonë”, nr. 1, Tiranë, 1985, f. 137.

⁵ Sh. Islamaj, *Sinonimia frazeologjike në gjuhën shqipe*. “Studime filologjike”, nr. 4, Tiranë, 1986, f. 123.

⁶ *Gramatika e gjuhës shqipe II – Sintaksa*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, f. 54-55.

Kjo për arsye se në sintaksë vërehen në shumë raste sinonimi elementesh, ndërtimesh e njësisish sintaksore⁷.

Në këtë kuadër, duhet pasur parasysh se “në sintaksë⁸ dy a më shumë ndërtime janë sinonimike kur, megjithëse paraqesin struktura sintaksore të ndryshme, shprehin të njëjtën përmbajtje kuptimore me ngjyrimë të veçanta që lidhen me stilin, me nivelin e ligjërit, me rrethanat ligjërimore etj.” Nuk duhet harruar gjithashtu se disa prej këtyre elementeve sintaksore kanë shprehësi më të qartë, duke paraqitur vlera më reale të përfaqësimit të një raporti sintaksor, ndërkohë që të tjerat mbeten më pak të qarta, për shkak të mangësive në përbashkësitë kuptimore përkatëse, siç ilustron në shembullin vijues:

- origjinali: *...Vetmia e syrit mbi ballin e oficerit të policisë... Mark, ç'është ky përfytyrim i çuditshëm? ...Kot, profesor... -I. Kadare, “Lulet e ftohta të marsit”, v. 2001, f. 54. transformimi: Mark, ç'po përfytyron në këtë mënyrë të çuditshme?*

Pavarësisht këtij problemi, duke vënë në zbatim teknikën e zëvendësimit të një shprehjeje, ose të një dukurie që shfaq elemente paqartësie në shprehësi, duke e zëvendësuar këtë shprehje me një tjetër që duket se plotëson më mirë nevojat e individit dhe të shoqërisë për qartësi, pra, duke vënë në zbatim procesin e transformimit ose të shndërrimit, që nuk është gjë tjetër, veçse zëvendësimi i një trajte, i një ndërtimi, me një trajtë ose ndërtim tjetër të vlerësuar si të barasvlershëm me rastin e parë, krijohet mundësia e përfuturit sa më të saktë dhe me sa më pak luhajtje të kuptimit real dhe të marrëdhënive me elemente të tjera kuptimore në brendësi të periudhës dhe të tekstit, në një mbulim sa më të plotë të tërësisë kuptimore dhe të sferës komunikative:

- origjinali: *Edhe ata që vjedhin edhe ata që vidhen njihen nga kjo gjë, - vazhdoi mjeshtri. – Të parët, siç të thashë, nga mënyra e shkallimit, të dytët nga zgjedhja e bravave. Dhe kjo është gjëja më e thjeshtë. I.Kadare, “Lulet e ftohta të marsit”, v. 2001, f. 51. - transformimi: Edhe ata që vjedhin edhe ata që vidhen njihen nga kjo gjë, - vazhdoi mjeshtri. – Të parët, siç të thashë, nga mënyra si i shkallmojnë, të dytët nga zgjedhja e bravave. ...*

- origjinali: *Një ide që kishte humbur udhën ndoshta, dhe që ashtu siç kishte behur rastësisht, ashtu dhe ka ikur e trembur, në kërkim të botës së saj. I.Kadare, “Lulet e ftohta të marsit”, v. 2001, f. 69. - transformimi: Një*

⁷ Gramatika e gjuhës shqipe 2, Sintaksa. Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Tiranë, 2002, f. 54-55.

⁸ S. Mansaku, Rreth sinonimisë sintaksore në shqipen e sotme letrare. “Gjuha jonë”, nr. 1. Tiranë, 1985, f. 133.

ide që kishte humbur udhën ndoshta, dhe që ashtu siç kishte behur rastësisht, ashtu dhe ka ikur e trembur, për të kërkuar botën e saj.

- origjinali: *Për habi askujt s'i kujtohej faji që kishte bërë familja apo fisi i vajzës. Faji i tmerrshëm që mund të shlyhej vetëm me flijimin e saj. I. Kadare, "Lulet e ftohta të marsit", v. 2001, f. 21. - transformimi: Faji i tmerrshëm që mund të shlyhej vetëm duke fljuar atë.*

Kështu, nëpërmjet një mekanizmi të tillë praktik e jetësor, në sfondin e sinonimisë sintaksore, në ndjekje të kësaj perspektive, konstatohen konkretisht analogjitë dhe afritë përkatëse lidhur me aspektet funksionale dhe semantike dhe, mbi të gjitha, vendi i përdorimit të secilës sintagmë.

Transmetimi dhe perceptimi i vlerave gjuhësore në ndërlidhjet dhe në ndërmarrëdhëniet e tyre përbën një tregues real të ndikimit të komunikimit edhe në aspektet e tjera të jetës, në mbarëvajtjen individuale, familjare, shoqërore, profesionale, kulturore e shpirtërore. Mbetet e nevojshme të gjenden ato vlera komunikative që ndihmojnë në qartësimin e situatave dhe në mbulimin më të efektshëm të hapësirës jetësore komunikative.

Rrjedhimisht, përparësia e komunikuesit në gjuhën shqipe bëhet njohja e mekanizmit gjuhësor të saj, duke integruar sa më shumë të jetë e mundur nga elementet e nevojshme, të cilave ua njeh cilësitë funksionale dhe relacionale.

Prandaj, për realizimin e një performance cilësore komunikative njihet si përparësi e komunikimit njohja e një mase të gjerë të alternativave sinonimike të shprehësisë. Falë njohjes në shtrirje e në thellësi të mekanizmit gjuhësor bëhet e mundur zgjedhja në çdo rast e njësisë së nevojshme, në të gjitha ligjërimet, stilet, situatat ligjërimore, edhe pse, në kushtet njerëzore, mundësitë mbeten potenciale, duke qenë njëkohësisht relative dhe subjektive, për ta pasur sa më të lehtë manovrimin nëpërmjet të gjitha burimeve që ofrojnë fjalët e një gjuhe, me të gjitha vlerat e tyre kuptimore e sintaksore.

